



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.08.2017

Ref.: 700/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.563/17, datë 20.07.2017 e BPrAL Kolegji "Heimerer" për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.575/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit te akreditimit sipas vendimit nr.573/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji "Heimerer":
 - Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, dhe
 - Shkencat Shëndetësore për Profile Terapeutike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Logopedi dhe Ergoterapi).
- III. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.573/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- IV. Lejohet regjistrimi i studenteve ne programet e cekura ne piken dy të këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Heimerer" me 20.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr. 573/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim BPrAL Kolegji "Heimerer" i është pezulluar akreditimi për programet e studimit: Pedagogji Profesionale në Shëndetësi/Fushë Profesionale e Infermierisë, BSc, 180 ECTS; Shkencat Shendetesore për Profile Terapeutike (Logopedi dhe Ergoterapi), BSc, 180 ECTS, dhe Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji Heimerer, është konstatuar që programet e cekura në pikën dy të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.573/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Heimerer;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

